

05.06.2012

GJYKATA KOMUNALE NË PRISHTINË

E.nr.94/2001

Dt. 01.06.2012

Prishtinë

KREDITORI; Oda Ekonomike e Kosovës Prishtinë të cilëne përfaqëson av Hamdi Podvorica nga Prishtina.

DEBITOR; Barnatorët e Regjionit të Prishtinës të cilën e përfaqëson av. Isak Hoxha nga Prishtina

Konform neneve 5.1, 6, 10.5, 26.1 dhe 228.1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (Ligji nr. 03/L-008) në çështjen e lirimit të lokalit nga njerëzit dhe sendet nga debitori e për llogari të kreditorit, me dt. 01.06.2012 gjyqtari nxjerr këtë;

KONKLuzion

Në bazë të Aktgjykimit të plotëfuqishëm dhe të ekzekutueshëm të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë XVI P. Br. 807/94 i dt. 17.11.1994 dhe aktvendimit për përmbartim E.nr.94/2001 i dt. 01.06.2001 është CAKTUAR përmbartimi kundër debitorit.

Gjykata me dt. 14.06.2012 në ora 10h do të bënë lirim dhe shpërnguljen nga njerëzit dhe sendet dhe personat e tretë duke ia dorëzuar në posedim dhe shfrytëzim të lirë Kreditorit Oda Ekonomike e Kosovës-lokalin afarist- Odës Ekonomike në Prishtinë rr. "Nëna Terezë" nr 20 ndësrtesa e Odës pjesa përdhese ana verilindore në sipërfaqe prej 94 m2 dhe bodrumit nën te me sipërfaqe prej 27 m2 në të cilët është e vendosur Barnatorja e tretë.

Personat zyrtarë të kësaj Gjykate (me asistimin e Policisë së Kosovës) me dt. 14.06.2012 duke filluar nga ora 10.00h dhe do të bëjnë zbrazjen dhe lirim dhe lokalit nga njerëzit dhe sendet dhe të lirë t'ia dorëzojnë në pronësi dhe posedim Kreditorit.

Njoftohet Policia e Kosovës që në datën e theksuar të lajmërohet në Gjykatën Komunale në Prishtinë në zyrën nr. 208 në ora 10h.

Këshilla Juridike; Kundër këtij Konkluzioni nuk është e lejuar ankesa.

